












MUSIKSCHULE  
HITZKIRCH  
*Musik begeistert.*



Informacione në shqip

# KURSET TONA

Çka mund të përjetoni tek ne.



## FORMIM MUZIKOR FILLESTAR

---

- Këngë dhe kërcim (kopsht dhe klasa e 1-rë)
- Muzikë dhe lëvizje\* (klasa e 1-rë)
- Shkolla fillore me ksilofon Orff (klasa e 2-të e sipër)
- Shkolla fillore me fyell (klasa e 2-të e sipër)
- Shkolla fillore me xhembe (klasa e 2-të e sipër)

\* “Musikë dhe lëvizje ” është një lëndë e integruar në planin mësimor të klasës së 1-rë fillore në shkollat Hitzkirch, Altwis, Gelfingen, Hämikon, Ermensee dhe Schongau, që do të thotë se është e detyrueshme për të gjithë fëmijët dhe pa pagesë.

## MËSIM INDIVIDUAL

---

- Mësim një herë në javë për fillestarë, kohëzgjatja 30 minuta
- Mësim një herë në javë për të përparuar, kohëzgjatja 40 minuta, sipas dëshirës edhe 30 minuta. (Mësimi i detyrueshëm i gjimnazit zgjat gjithmonë 40 minuta.)

Për fëmijët deri në klasën e 3-të, lutemi të na kontaktoni para regjistrimit, që të sqarojmë, nëse do të fillohet me mësimin e një instrumenti dhe nëse po, në ç'mënyrë.

## MËSIM NË GRUP

---

- Mësim një herë në javë, kohëzgjatja 40 minuta me 2 nxënës/e.
- Mësim një herë në javë, kohëzgjatja 50 minuta me 3 – 4 nxënës/e.

Nëse nuk ka regjistrime të mjaftueshme për një mësim në grup, atëherë do të mbahet automatikisht mësimi individual me 30 minuta.

## ANSAMBLET

---

Kori i fëmijëve – kori i të rinjve – ansambli i fyellit – muzikë rajonale për të rinj– ansambli i instrumenteve me harqe – ansambli i kitarrës – bandë rock-u

Të luajmë bashkë muzikë – një mundësi e çmuar për të plotësuar mësimin individual ose në grup. Pjesëmarrja në ansambël është për nxënësit e shkollës së muzikës Hitzkirch pa pagesë.

## KURSE PËR TË RRITUR

---

- Mësim një herë në javë, kohëzgjatja 30 minuta ose 40 minuta
- Abonim 10-ësh për 10 mësim me zgjedhje të lirë – edhe me instrumente të ndryshme – ndjekja e mësimi gjatë vitit (oraret caktohen me marrëveshje)

## INSTRUMENTET TONA / TRAJNIM VOKAL

---

**Instrumente me tela** - violinë, violinë Suzuki, violinqel, kontrabas\*, ukulele, kitarrë akustike, kitarrë elektronike, bas elektronik, harpë\*

**Instrumente me tastierë** - piano\*, keyboard\*, fizarmonikë, Schwyzerörgeli [organo e vogël zvicerane]

**Trajnim vokal** - vokal solo / Jodeln

**Instrumente frymore druri** - flaut, fyell i panit, oboe, klarinetë, saksofon, fagot, flaut i sopranos

**Instrumentet e tunxhit** - trompetë, kornet, korno alto, korno, trombon, eufonium, bariton, tuba, korno alpine

**Instrumentet e perkusionit** - set timpanesh\*, ksilofon koncerti\*, perkusion\*, xhembe

\*nuk ka mundësi për mësim në grup

## KOSTOT

Çfarë duhet të llogarisni.



**PËR FËMIJË DHE TË RINJ (DERI 20 VJEÇ)** Çmimi vlen për një vit të plotë shkollor.

## FORMIM MUZIKOR FILLESTAR («SHKOLLA FILLORE»)

---

Këngë dhe kërcim (10 mësim)	50.--	mosha e kopshtit e sipër
ksilofon 1 dhe 2, fyell 1 dhe 2,	400.--	klasa e 2-të e sipër
xhembe 1 dhe 2		

## MËSIM INSTRUMENTAL DHE TRAJNIM VOKALI

---

Instrument ose trajnim vokali	mësim individual	mësim në grup
	30 min.	(40/50 min.)
Të gjitha instrumentet		
Ose trajnim vokali	710.--	900.--
		470.--

## ÇMIMET PËR NXËNËSIT E GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE TË MESME PROFESIONALE

---

Mësimi instrumental dhe vokal i **detyrueshëm** në gjimnaze dhe shkolla të mesme profesionale zgjat 40 minuta/për leksion dhe kushton gjithmonë 1'030.- Fr. në vit.

Mësimi instrumental dhe vokal **me dëshirë** kushton si te lista më sipër.

## ÇMIMET PËR ANSAMBLET

---

Mësimi i ansamblës për nxënëset dhe nxënësit me mësim instrumental në shkollën e muzikës Hitzkirch është pa pagesë. Për nxënës/e, që nuk ndjekin mësimin në shkollën e muzikës Hitzkirch, mësimi i ansamblës do të kushtonte 160.- Fr. për një vit shkollor.

## ZBRITJE ÇMIMI FAMILJARE

---

Familjet me dy ose më shumë fëmijë në shkollën e muzikës përfitojnë një **ulje çmimi familjare**:

Familjet me 2 fëmijë\* në shkollën e muzikës **10%** zbritje nga shuma e përgjithshme

Familjet me 3 ose më shumë fëmijë\* në shkollën e muzikës **15%** zbritje nga shuma e përgjithshme

\*Mësimi i integruar në «muzikë dhe lëvizje» në Volksschule si dhe ndekja e kurseve afatshkurta dhe e mësimin të ansamblit nuk quhen si «fëmijë në shkollën e muzikës».

Familjet me kushte të vështira ekonomike mund të bëjnë kërkesë për një **ulje shtesë çmimi** tek autoritetet lokale. Lutemi drejtojuni autoriteti tuaj lokal.

## PËR TË RRITUR (20 VJEÇ E SIPËR)

Mësim individual njëherë në javë	30 minuta	2'080.--në vit
Mësim individual njëherë në javë	40 minuta	2'775.-- në vit
Mësim individual njëherë në javë	50 minuta	3'470.-- në vit
Çdo 14 ditë		Gjysma e kosos
Abonim 10-ësh	30 minuta	555.--
Abonim 10-ësh	40 minuta	740.--
Abonim 10-ësh	50 minuta	925.--
Abonim 10-ësh	60 minuta	1'100.--

# INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Çka nevojitet.



## KURSI vlen për

---

fëmijë, të rinj dhe të rritur që banojnë në komunat Aesch, Ermensee, Hitzkirch ose Schongau.

## MËSIMI

---

Kohëzgjatja: Një vit shkollor  
Fillimi: Java e dytë shkollore pas pushimeve verore  
Koha e mësim: pas mbarimit të mësimin në Volksschule, gjatë kohës së drekës, në pasditet ku nuk ka mësim (pasi është rënë dakort nga të dy palët)

## TARIFA SHKOLLORE

---

Tarifa shkollore duhet të paguhet në paradhënie. Nëse keni nevojë për një pagesë me këste, lutemi të na kontaktoni.

## PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË ADRESËS

---

4–6 herë në vit do t'ju vijë **gazeta** e shkollës sonë të muzikës. Mund të ndodhë që të dhënat tuaja të kontaktit t'ia përcjellim për një qëllim të caktuar shoqatave muzikore të rajonit. Nëse nuk e dëshironi këtë gjë, na njoftoni me anë të një shënimi të shkurtër.


## PREZANTIM INSTRUMENTESH, MËSIMI PËR PROVË, AKTIVITETE

---

**Aktivitetet** tona aktuale, datën e **prezantimit të instrumenteve** si dhe informacionin në lidhje me ndjekjen e **një ore mësimi për provë** i gjeni në faqen tonë të internetit [www.musikschule-hitzkirch.ch](http://www.musikschule-hitzkirch.ch) tek rubrika «Agenda».

## KONTAKTI


Si të na arrini.



Musikschulleiter [Drejtori i shkollës së muzikës] Geri Amrein  
Musikschulhaus [ndërtesa e shkollës së muzikës], Bahnhofstrasse 1, 6285 Hitzkirch  
Nr. telefoni - 041 917 00 61  
E-mail – [schulleitung@musikschule-hitzkirch.ch](mailto:schulleitung@musikschule-hitzkirch.ch)  
Web – [www.musikschule-hitzkirch.ch](http://www.musikschule-hitzkirch.ch)

# Regjistrimi

Ju mirëpresim me kënaqësi.



Lutemi regjistrohuni online tek:

[www.musikschule-hitzkirch.ch/anmelden](http://www.musikschule-hitzkirch.ch/anmelden)

Regjistrimi vlen në mënyrë të detyrueshme për të gjithë vitin shkollor. Parimisht çregjistrimet gjatë vitit shkollor nuk janë të mundura. Nëse e ndërprisni kursin nuk keni të drejtë ta merrni mbrapsht tarifën shkollore. (Përjashtim: shpërngulje, arsye shëndetësore me atest mjekësor). Çregjistrimet duhet të bëhen me shkrim